



KËSHILLI I EVROPËS

ROJTARI I TË
DREJTAVE TË NJERIUT

PËRMBLEDHJE

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



SHTETET ANËTARE

■ Andorra, Armenia, Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Holanda, Hungaria, Irlanda, Islanda, Italia, Kroacia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Mali i Zi, Malta, Maqedonia e Veriut, Mbretëria e Bashkuar, Moldavia, Monakoja, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Qiproja, Rumania, San Marinoja, Serbia, Shqipëria, Republika Slloake, Sllovenia, Spanja, Suedia, Turqia, Ukraina, Zvicra.

SHTETET VËZHGUESE

■ Japonia, Kanadaja, Meksika, Selia e Shenjtë (Vatikani), Shtetet a Bashkuara të Amerikës.

SELIA QENDRORE DHE ZYRAT

■ Zyra kryesore e Këshillit të Evropës gjendet në Strasburg, Francë. Në të janë të punësuar 2 300 persona dhe përfshin zyra të jashtme dhe ndërlidhje me organizatat e tjera ndërkombëtare. Qendrat Evropiane të Rinisë në Strasburg dhe në Budapest ofrojnë trajnim të të rinjve për çështje të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut.

BUXHETI

■ Buxheti i përgjithshëm i Këshillit të Evropës për vitin 2024 është 624,6 milionë euro. Buxheti financohet kryesisht nga shtetet anëtare.

*All references to Kosovo, whether to its territory, institutions or population, in this case shall be understood to mean Kosovo with United Nations Security Council Resolution 1244 and without prejudice to the status of Kosovo.



KËSHILLI EVROPËS



Alain Berset
Sekretar i Përgjithshëm

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut.

Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

■ Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare. Individët mund të çojnë aplikime për shkelje të të drejtave të njeriut në Gjykatën e Strasburgut, pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë e ankimit në shtetet anëtare përkatëse.

■ Bashkimi Evropian po përgatitet të nënshkruajë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke krijuar një hapësirë të përbashkët ligjore evropiane për mbi 700 milionë qytetarë. ■■■



RUAJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

— Këshilli i Evropës mbrohet lirinë e shprehjes dhe të medias, lirinë e organizimit, barazinë dhe mbrojtjen e pakicave. Ai ka ndërmarrë fushata për çështje të tilla si për mbrojtjen e fëmijëve, gjuhën e urrejtjes online dhe të drejtat e Romëve, të cilët përbëjnë pakicën më të madhe në Evropë.

— Këshilli i Evropës i ndihmon shtetet anëtare të luftojnë korrupsionin dhe terrorizmin dhe të ndërmarrin reformat e nevojshme ligjore. Grupi i tij i ekspertëve për çështjet kushtetuese, i njohur si Komisioni i Venecias, ofron këshillim ligjor për shtetet në mbarë botën.

— Këshilli i Evropës promovon të drejtat e njeriut nëpërmjet konventave ndërkombëtare, të tilla si Konventa për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe Konventa për Krimin Kibernetik. Ai monitoron progresin e shteteve anëtare në këto fusha dhe bën rekomandime nëpërmjet organeve të pavarura të ekspertëve për monitorimin.

— Sot nuk ka as edhe një shtet të vetëm anëtar të Këshillit të Evropës që aplikon dënimin me vdekje. ■■■



BASHKËPUNIMI RAJONAL

Organet monitoruese

- ▶ Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO)
- ▶ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT)
- ▶ Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA)
- ▶ Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)
- ▶ Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit (MONEYVAL)
- ▶ Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)
- ▶ Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (ECSR)
- ▶ Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
- ▶ Komiteti i Ekspertëve për Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave

— Këshilli i Evropës punon në bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Evropian, me Kombet e Bashkuara, me Organizatën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë dhe me shumë shtete partnere në të gjithë botën.

— Për shembull, Drejtoria Evropiane e Këshillit për Cilësinë e Medikamenteve dhe Kujdesin Shëndetësor, e cila luan rol kyç në luftën kundër medikamenteve të falsifikuara, ka marrëveshje me Brazilin, Kinën, Afrikën e Jugut dhe Shtetet e Bashkuara. ■■■



STRUKTURA

— Përveç **Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, Këshilli i Evropës përbëhet nga shumë institucione pune.

- ▶ **Sekretari i Përgjithshëm** drejton dhe përfaqëson Këshillin e Evropës.
- ▶ **Komiteti i Ministrave**, i përbërë nga ministrat e jashtëm dhe përfaqësuesit e shteteve anëtare funksionon si organi kryesor vendimmarrës.
- ▶ **Asambleja Parlamentare** përbëhet nga 612 deputetë nga 46 shtete anëtare; Asambleja zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm, Komisionerin për të Drejtat e Njeriut dhe gjyqtarët e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ai ofron një forum demokratik për debate dhe për monitorimin e zgjedhjeve; komitetet e tij luajnë rol të rëndësishëm për shqyrtimin e çështjeve aktuale.
- ▶ **Komisioneri për të Drejtat e Njeriut** trajton dhe sjell në vëmendje shkeljet e të drejtave të njeriut.
- ▶ **Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale** është përgjegjës për forcimin e demokracisë lokale dhe rajonale. Ai përfshin 612 përfaqësues të zgjedhur, të cilët përfaqësojnë më shumë se 150 000 autoritete lokale dhe rajonale.
- ▶ **Konferenca e Organizatave Ndërkombëtare Joqeveritare** përfaqëson shoqërinë civile dhe nxit demokracinë pjesëmarrëse.



ALB

Avenue de l'Europe • 67075 Strasbourg • FRANCE

Vizitoni faqen tonë kryesore të internetit në adresën
www.coe.int



Faqja e internetit për botimet e Këshillit të Evropës
book.coe.int

Dokumentacioni dhe burimet online në faqen e internetit
edoc.coe.int

